



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 169 prot.

Kamëz, më 19. 12. 2024

V E N D I M
Nr. 125 .Datë 19/12 2024
M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE SHITESË QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË NË VAZHDIM”, PËR VITIN 2024”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.94 Datë 13.12.2024 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, VKB nr.44 datë 13.04.2022 “Për miratimin e procedurave lidhur me programin social Subvencioni Interesave të Kredisë”; Relacionit Komisionit Strehimit me nr.10554 Prot datë 12.12.2024, Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.10554/1 Prot datë 12.12.2024 , **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së familjeve shtesë për të përfutuar nga programi Strehimit Social “Subvencionimi i interesave të kredisë në vazhdim”, për vitin 2024, sipas Aneksit nr. 1, dhe relacionit shpjegues bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Familjet e përcaktuara në Aneksin nr. 1 të këtij vendimi, duhet të paraqiten brenda gjashtë muajve pranë institucionit bankar, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Kamëz.
Mosrespektimi i këtij afati është shkak për skualifikimin e tyre.
3. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi. .
Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
4. Ky vendim, hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

